

GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS
përmes **GJYKATËS THEMELORE TË PRISHTINËS**
DEPARTAMENTIT PËR ÇËSHTJE ADMINISTRATIVE

lidhur me lëndën **A. nr. 3090/19 (AA. nr. 355/20)**

Paditës:

Sami Kurteshi, rr. Xhavit Ahmeti, nr. 9/A, 10000 Prishtinë
përfaqësuar me autorizim nga juristi Getoar Mjeku

ndaj të paditurës:

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRë) e Republikës së Kosovës
rr. Dervish Rozhaja, nr. 12, 10000 Prishtinë

me palët e interesuara:

- (1) «Alsi & CO – Kosovë L.L.C» SH.P.K., nr. unik id. 810875552
- (2) «VBS» SH.P.K., nr. biz. 70325365
- (3) «Vita Energy» SH.P.K., nr. biz. 71218376
- (4) «Abrazen LLC», nr. biz. 70100453
- (5) «Energy Development Group Kosova» SH.P.K., nr. biz. 717276643
- (6) «Solar Gate LLC», nr. biz. 71280888
- (7) «Building Construction», pa adresë ose numër identifikimi
përfaqësuar me autorizim nga avokatët —
— Faton Qirezi, rr. Muharrem Fejza, hy. C15/15, nr. 23, 10000 Prishtinë
— Alban Makolli, rr. Muharrem Fejza, hy. C15/17, nr. 5, 10000 Prishtinë

PËRGGJIGJE NË KËRKESË PËR
RISHQYRTIM TË JASHTËZAKONSHËM

sipas Ligjit për konfliktet administrative, neni 52.2
ndaj Kërkesës së 30 qershorit 2020 të palëve të interesuara

Prishtinë, 13 korrik 2020

Përfaqësues i paditësit:

Dr. Getoar Mjeku, jur.
Rr. Enver Maloku, nr. 110
10000 Prishtinë
+383 45 30 52 00
gm@getoar.com

Përmbajtja

I. Hyrje.....	3
A. Përmbledhje.....	3
B. Çështje në shqyrtim.....	3
C. Arsyetimi juridik.....	4
II. Procedura dhe faktet.....	5
A. Procedura.....	5
B. Palët.....	6
C. Faktet.....	6
III. Argumentet.....	7
A. Kërkesa e palejueshme: Palë pa subjektivitet juridik.....	7
B. Kërkesa e palejueshme: Rishqyrtimi s’lejohe për faktet.....	7
C. Aktvendimet dhe shkresat tregojnë qartë pse u shty vendimi.....	8
D. Ligji e vendimi i Kushtetueses njohin legjitimitetin e paditësit.....	9
IV. Propozim.....	11

I. HYRJE

A. Përmbledhje

1. Ky rast ka të bëjë me vendim të organit rregullator që do të shtrenjton-te rrymën. Rregullatori thotë se konsumatorët do të paguajnë 27,6 milionë euro. Mbështetur në ligj dhe jurisprudencën kushtetuese, që u mundëson qytetarëve të sfidojnë tarifën, z. Kurteshi ka ngritur padi për anulimin e vendimit të rregullatorit, duke kërkuar shtyrjen e ekzekutimit deri në shqyrtimin përfundimtar.
2. Gjykata Themelore ka miratuar kërkesën për shtyrje, dhe Gjykata e Apelit ka vërtetuar aktvendimin e Themelores. Vendimet gjyqësore mbështeten në 7 parashtresat e paditësit, që provojnë arsyet e shtyrjes: vendimi i së paditurës i shkakton paditësit dëm të pariparueshëm, interesi publik kërkon shtyrjen dhe shtyrja nuk dëmton askënd.
3. Me këtë përgjigje, z. Kurteshi i kërkon Gjykatës së nderuar të hedhë poshtë kërkesën e palëve që s'kanë subjektivitet juridik, të hedhë poshtë kërkesën për aq sa synon shqyrtimin e fakteve, si dhe ta refuzojë për aq sa prek procedurën dhe të drejtën materiale. Përfundimisht, Gjykata Supreme duhet të vërtetojë Aktvendimin e 17 qershorit 2020 të Gjykatës së Apelit.

B. Çështje në shqyrtim

4. Në shqyrtim para Gjykatës janë këto katër çështje kryesore:
 - (1) Mjetet juridike nuk mund të ushtrohen pa pasur interes juridik ose pa qenë person fizik a juridik.¹ «VBS» SH.P.K. dhe «Building Construction» nuk janë identifikuar si persona juridikë ose biznese të regjistruara me numër e adresë të saktë. A u lejohe kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm?
 - (2) Sipas ligjit, rishqyrtimi i jashtëzakonshëm i vendimit lejohet për shkelje të së drejtës materiale ose procedurale, por jo për çështje të fakteve.² Palët e interesuara pretendojnë se dy shkallët e para

1 Ligj 03/L-202 për konfliktet administrative (LKA), nenet 18 e 21.

2 LKA, neni 24.2.

kanë konstatuar gabimisht rrethanat për shtyrje ekzekutimi. A lejohet rishqyrtimi i jashtëzakonshëm i vendimit për këtë çështje?

- (3) Sipas rregullave të procedurës, aktvendimi ose shkresat e lëndës duhet të bëjnë të qarta arsyet për vendimin gjyqësor.³ Apeli e Themelorja kanë miratuar shtyrjen e ekzekutimit, duke u thirrur në parashtrësat e propozuesit. Propozuesi ka dhënë argumente e prova të qarta, me fjalë, aritmetikë e dokumente, duke dëshmuar se po i kanoset dëm i pariparueshëm, se interesi publik përkrah shtyrjen dhe se shtyrja nuk dëmton të tjerët. A është e qartë pse është nxjerrë aktvendimi për shtyrje të ekzekutimit?
- (4) Gjykata Kushtetuese ka njohur të drejtën e qytetarëve për të sfiaduar tarifatat e caktuara nga organet shtetërore.⁴ Kurse ligji lejon qytetarin të ngrejë padi ndaj aktit administrativ që ia cenon të drejtat ose interesat, drejtpërdrejt ose tërthorazi.⁵ E paditura tashmë ka pranuar se vendimi i saj i 27 nëntorit 2019 do t'u kushtojë paditësit dhe konsumatorëve të tjerë rreth 27,6 milionë euro. A ka të drejtë z. Kurteshi, si konsumator, të ngrejë padinë?

C. Arsyetimi juridik

5. Kur një palë parashtron kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit, gjykata ia dërgon një kopje palës tjetër, e cila mund të paraqesë përgjigje brenda 15 ditësh.⁶ Kërkesa i është dorëzuar përfaqësuesit të paditësit më 7 korrik 2020. Paditës po paraqet këtë përgjigje në gjykatën e duhur dhe brenda fatit, andaj përgjigjja duhet të shqyrtohet.

3 LKA, neni 63; Ligj 03/L-006 për procedurën kontestimore, ndryshuar me ligjin 04/L-118 (LPK), nenet 160, 175 e 182.2(n).

4 KI 11/09, *Krasniqi k. RTK dhe KEK*, Vendim, GjK, 16.10.2009, f. 3, para. fundit.

5 LKA, nenet 10.1 dhe 21.

6 LKA, neni 52.2.

II. PROCEDURA DHE FAKTET

A. Procedura

6. Më 24 dhjetor 2019, paditësi Kurteshi ka parashtruar padi ndaj një vendimi të së paditurës ZRrE, duke kërkuar edhe shtyrjen e ekzekutimit të vendimit. Gjykata Themelore e Prishtinës ka miratuar kërkesën me Aktvendimin e 27 dhjetorit 2019.
7. Gjatë janarit dhe shkurtit 2020, e paditura ZRrE dhe dy palë të interesuara kanë paraqitur ankesa të ndara ndaj Aktvendimit të 27 dhjetorit.⁷ Z. Kurteshi ka deponuar përgjigje në secilën ankesë.⁸
8. Më 20 shkurt 2020, Gjykata e Apelit ka prishur Aktvendimin e 27 dhjetorit 2019, dhe ka kthyer çështjen në rishqyrtim.⁹ (Për arsye të panjohura për ne, Apeli përmend vetëm një nga tri përgjigjet tona.)
9. Më 4 mars 2020, Gjykata Themelore e Prishtinës ka nxjerrë aktvendim, i cili i kërkonte paditësit «prova apo fakte të bindshme» për të mbështetur kërkesën për shtyrje të ekzekutimit.
10. Më 5 mars 2020, pa iu njoftuar Aktvendimi i 4 marsit, paditësi ka ripërsëritur kërkesën për shtyrje. Kurse më 12 mars 2020, ka dorëzuar parashtresën dhe provat plotësuese sipas Aktvendimit të 4 marsit. Parashtresa ka shtjelluar në hollësi ndikimin që tarifata e caktuara nga ZRrE kanë mbi konsumatorët, duke përfshirë zotin Kurteshi.
11. Duke u mbështetur në parashtresën e 12 marsit dhe provat plotësuese të dorëzuara nga z. Kurteshi, Gjykata Themelore e Prishtinës ka rivendosur shtyrjen e ekzekutimit me Aktvendimin e 6 prillit 2020.
12. Një varg palësh të interesuara, përfshi ankues të mëparshëm, kanë paraqitë ankesë më 22 prill. E paditura është ankuar më 10 qershor. Paditësi Kurteshi ka dorëzuar përgjigjen e vet më 15 qershor.

7 Ankesë e së paditurës, 23.1.2020, dorëzuar 28.1.2020; Ankesë e palës së interesuar, 13.2.2020, dor. 7.2.2020; Ankesë e palës së interesuar, 10.2.2020, dor. 20.2.2020.

8 Përgjigje në ankesën e së paditurës, 30.1.2020; Përgjigje në ankesën e palës së interesuar, 13.2.2020; Përgjigje në ankesën e palës së interesuar, 21.2.2020.

9 Aktvendim AA.nr.155/2020, GjAK, 20.2.2020.

13. Më 17 qershor 2020, Gjykata e Apelit i ka refuzuar ankesat dhe ka vërtetuar Aktvendimin e 6 prillit të Themelores.¹⁰

B. Palët

14. Paditësi Sami Kurteshi është shtetas i Republikës së Kosovës dhe konsumator i energjisë elektrike.¹¹

15. E paditura Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRrE) e Republikës së Kosovës cakton tarifat, që përfundimisht paguhen prej konsumatorëve.

16. Palët e interesuara janë biznese që thonë se merren me energjetikë. 2 nga 7 palët nuk mund të identifikohen si biznese të regjistruara.

C. Faktet

17. Për shkak të kostos dhe rëndësisë, *burimet e ripërtërishme të energjisë* (BRE) gëzojnë trajtim të veçantë në vendimet e rregullatorit. BRE përfshin ujin, diellin, erën, biomasën dhe burime të tjera.

18. Më 27 nëntor 2019, ZRrE ka nxjerrë vendim për një skemë mbështetëse të prodhimit të energjisë diellore (fotovoltaike). Vendimi parasheh tarifa nxitëse (*feed-in*) prej 85,5 eurosh për megavat orë.¹² Kjo tarifë është dukshëm mbi çmimin e tregut, dhe shërben si subvencion.

19. Nga skema e ZRrE-së përfiton një listë të caktuar prodhuesish. Skema do të mbështesë kapacitetin prej 20 MWh, me një kufizim prej 3 MW për prodhues. Por gati të gjithë prodhuesit kanë një adresë, një vend operimi dhe të njëjtin pronar.

20. Skema mbështetëse do të vazhdojë për një periudhë 12-vjeçare.

21. Në prill 2020, e paditura ZRrE ka pranuar se subvencionet u faturohen përfundimisht konsumatorëve, të cilët do të paguajnë 27,6 milionë euro. Ndërkohë, Komisioni i Ndihmës Shtetërore dhe Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës po hetojnë rastin.¹³

10 Aktvendim AA.nr.355/2020, GjAK, 17.6.2020.

11 Parashtrësë e paditësit, 12.3.2020, shtojca 1: Faturë e energjisë elektrike.

12 Vendimin V_1204, ZRrE, 27.11.2019, para. VI.

13 Përgjigje në ankesën e palëve të interesuara, 15.6.2020., para. 21–25.

III. ARGUMENTET

22. Së pari, Gjykata duhet të largojë nga procedura dy nga shtatë parashtruesit, të cilët nuk gëzojnë subjektivitet juridik, dhe të hedhë kërkesën sa u përket çështjeve të fakteve. Pastaj, duhet të refuzojë kërkesën sa u përket çështjeve procedurale dhe të drejtës materiale.

A. Kërkesa e palejueshme: Palë pa subjektivitet juridik

23. Pala që nuk është as person fizik as juridik nuk mund të ushtrojë mjete juridike.¹⁴ Në hyrje të kërkesës, figurojnë si parashtrues «palët me interes juridik», gjithsej 7 biznese, që thonë se merren me energji. Jo të gjitha janë shoqëri tregtare të regjistruara ose të identifikuara si duhet.

24. I dyti në listë është parashtruesi «VBS» SH.P.K., vetidentifikuar me numrin e biznesit 70325365. Por në Agjencinë e Regjistrimit të Biznesit, ky numër i përket një entiteti tjetër, «Birra Peja» SH.A.,¹⁵ dhe me emrin «VBS» shfaqen dy shoqëri, çka na pamundëson të gjejmë palën e saktë dhe të konkludojmë se pala ka interes juridik për kërkesën.

25. I fundit në listë është parashtruesi «Building Construction». Ndonëse pretendon të jetë person juridik, nuk është i tillë. Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve nuk ka asnjë entitet të regjistruar me emrin «Building Construction», dhe kërkesa nuk ka as emër biznesi të regjistruar, as adresë fizike të palës, as numër identifikues. Parashtruesi nuk ka personalitet juridik, andaj nuk mund të ushtrojë mjete juridike.

26. Kështu, kërkesa e dy parashtruesve duhet hedhur poshtë si e palejueshme. Dhe sa herë përmendet parashtruesit ose palët e interesuara, duhet nënkuptuar palët e tjera, pa «VBS» e «Building Construction».

B. Kërkesa e palejueshme: Rishqyrtimi s'lejohe për faktet

27. Sipas nenit 24.2 LKA, rishqyrtimi i jashtëzakonshëm i vendimit lejohe vetëm për shkelje të dispozitave të procedurës dhe për zbatimin e gabuar të së drejtës materiale. Gjykata Supreme nuk merr parasysh pretendimet për konstatim të gabuar të gjendjes faktike.

14 Shih LKA, nenet 18 e 21.

15 Shih shënimet në ARBK, <https://arbk.rks-gov.net/page.aspx?id=2,38,44359>.

28. Gjykata Themelore ka vendosë për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ, pasi ka konstatuar se janë përmbushë kushtet për shtyrje sipas nenit 22 LKA. Konstatimi, i vërtetuar nga Apeli, përbën vlerësim të fakteve. Por parashtruesit e kërkesës tani po e sfidojnë këtë vlerësim, ani pse nuk lejohet në rishqyrtim të jashtëzakonshëm. Fokusin e gabuar të kërkesën e vërejmë edhe te gjuha e përdorur, me formulime si «gjykata e shkallës së parë gabimisht ka konstatuar, kurse gjykata e shkallës së dytë ka rikonstatuar».¹⁶
29. Gjykata Supreme duhet të shpërfillë ato pjesë të kërkesës që riadresojnë çështjet e fakteve.¹⁷ Argumentet tona për këtë çështje i kemi paraqitur në çdo parashtresë, dhe sidomos në Përgjigjen tonë të 15 qershorit 2020 në ankesën e palëve të interesuara, pjesa IV.C., paragrafët 50–84.
30. Në çdo rast, Gjykata do të vërejë se argumentet e parashtruesve lidhur me nenin 22 LKA nuk kanë të bëjnë me shtyrjen e ekzekutimit, si masë gjyqësore, por me vetë meritat e padisë. Shqyrtimi i meritave nuk lejohet në këtë fazë të procedurës.¹⁸

C. Aktvendimet dhe shkresat tregojnë qartë pse u shty vendimi

31. Gjykata arsyeton vendimin e vet, duke u thirrë në të drejtën materiale, duke cekë faktet e provat ose duke u mbështetë në shkresat e lëndës.¹⁹ Aktvendimi i Themelores arsyeton qartë vendimmarrjen duke cituar nenin 22 LKA, duke theksuar faktet siç është dëmi i pariparueshëm që pëson paditësi, dhe duke vërejtur argumentet dhe provat e bollshme të paditësit. Po ashtu konstaton se paditësi Kurteshi ka sjellë provat bindëse që Apeli i ka cilësuar të munguara kur ka shqyrtuar rastin herën e parë.²⁰ Apeli tashmë ka vërtetuar aktvendimin e Themelores.²¹
32. Arsyet për shtyrjen e ekzekutimit i gjejmë gjithashtu në shkresat e lëndës. Në plot 7 parashtresa, paditësi Kurteshi ka shpjeguar në hollësi

16 Kërkesa e palëve të interesuara, para. 20, f. 8.

17 Po aty, paragrafët 8 dhe 16–20.

18 Shih Përgjigjen në ankesën e palëve, 15.6.2020, para. 85–90.

19 LKA, neni 63; LPK, nenet 160, 175 e 182.2(n).

20 Aktvendim, 6.4.2020 (citon Aktvendimin AA.nr.155/2020).

21 Aktvendim AA.nr.355/2020, 17.6.2020.

pse duhet shtyrë përmbartimi i vendimit të së paditurës.²² Parashtresat për imtësojnë me shifra e aritmetikë shumë të shumën që u mvishet konsumatorëve dhe përmbajnë rreth 20 dokumente të propozuara si prova.

33. Sipas nenit 22 LKA, gjykata miraton kërkesën për shtyrje ekzekutimi të një vendimi administrativ nëse plotësohen tri kushte: (1) ekzekutimi i vendimit i sjell dëm vështirë të riparueshëm paditësit; (2) shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik; dhe (3) shtyrja nuk u shkakton «dëm të madh» palëve të interesuara.²³
34. Nga shkresat e lëndës kuptohet qartë se janë përmbushë të tri elementet. Së pari, vendimi i së paditurës shkakton dëm të pamatshëm e të riparueshëm, duke ua ngarkuar konsumatorëve dhjetëra miliona euro, që përkthehen në qindra a mijëra për secilin; vetë e paditura ka pranuar dëmin.²⁴ Së dyti, shtyrja është në përputhje me interesin publik, sepse mbron konsumatorin dhe tregun e lirë, mbron pronën nga tjetërsimi i paligjshëm dhe parandalon pasurimin e pabazë. Së treti, shtyrja nuk i pakëson fare (dhe qebesa rrit) përfitimet e palëve të tjera nga vendimi i goditur, meqë ato zgjasin për periudhë fikse 12-vjeçare, pa marrë parasysh se kur fillon zbatimi.
35. Arsyet e vendimit pra janë të qarta, dhe Gjykata e nderuar duhet të refuzojë pretendimet e parashtresave për shkelje procedurale. Aktvendimet e Themelores dhe të Apelit duhet të vërtetohen.

D. Ligji e vendimi i Kushtetueses njohin legjitimitetin e paditësit

36. Këtu po riprodhojmë gati fjalë për fjalë argumentet që i kemi paraqitë tashmë Gjykatës së Apelit.²⁵ Z. Kurteshi gëzon legjitimitet falë vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe falë ligjit. E paditura ZRrE ka pranuar dëmin, kurse shtyrja e ekzekutimit dhe pandemia ka bërë që dëmi të mos ndodhë sivjet.

22 Padi dhe kërkesë për shtyrje të ekzekutimit, 24.12.2019; Përgjigje në ankesën e së paditurës, 30.1.2020; Përgjigje në ankesën e palës së interesuar, 13.2.2020; Përgjigje në ankesën e palës së interesuar, 21.2.2020; Parashtresë, 5.3.2020; Parashtresë, 12.3.2020; Përgjigje në ankesën e palëve të interesuara, 15.6.2020.

23 LKA, neni 22.2.

24 Përgjigje në ankesën e palëve të interesuara, 15.6.2020, para. 23.

25 Po aty, 43–47.

37. Ligji për konfliktet administrative lejon padi ndaj aktit përfundimtar që rrjedh prej procedurës administrative.²⁶ Edhe Ligji për rregullatorin e energjisë parasheh që vendimet e bordit të ZRrE-së të kundërshtohen përmes padisë në gjykatë.²⁷ Vetë vendimi i ZRrE-së thekson se është përfundimtar në procedurë administrative, dhe udhëzon palët në konflikt administrativ pranë gjykatës kompetente.²⁸
38. Padi për konflikt administrativ mund të ushtrojë cilado palë e tretë, person fizik a juridik, interesin e së cilës e prek vendimi i goditur — qoftë drejtpërdrejt, qoftë tërthorazi.²⁹ Në rastin *Krasniqi kundër RTK-së dhe KEK-ut*, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës ka njohur të drejtën e qytetarëve për të sfiduar tarifatat të cilat duhet të paguajnë për shkak të një vendimi shtetëror.³⁰
39. Në rastin tonë, z. Kurteshi është palë së cilës i dëmtohen interesat me vendimin e së paditurës. Padiësi është konsumator i energjisë elektrike. Subvencionet në formë të tarifave nxitëse, dukshëm mbi çmimin e tregut, ndikojnë në shtrenjtimin e rrymës për konsumatorët. Vetë e paditura e pranon se konsumatorët duhet të paguajnë subvencionet.³¹
40. Konsumatorët vërtet kanë qenë me fat që rryma nuk është shtrenjtuar sivjet. Kur më 17 prill ka caktuar tarifatat që konsumatori fundor do të paguajë më 2020, ZRrE nuk i ka ngritur ato për shkak të pandemisë së koronavirusit. Por ndikim ka pasur edhe Aktvendimi i 6 prillit, që ka shtyrë ekzekutimin e vendimit të ZRrE-së për të subvencionuar 20 MW nga burimet diellore. Tani parashtruesit pretendojnë gabimisht se padia e zotit Kurteshi është e parakohshme, sepse vendimi i ZRrE-së nuk ka shtrenjtuar rrymën. Nuk e ka shtrenjtuar, falë pandemisë dhe gjykatës, por mund ta shtrenjtojë në mot, përveç nëse mbetet i pezulluar — dhe pezullimi apo shtyrja dëshmon interesin e padiësit.
41. Padië e ka parashtruar pala e duhur dhe në kohën e duhur. Ligji, vendimet e Gjykatës Kushtetuese dhe rrethanat e rastit njohin legjitimitetin aktiv të padiësit.

26 LKA, nenet 13.2 dhe 27.1.

27 Ligj 05/L-084 për rregullatorin e energjisë, neni 49.

28 Vendimin V_1127_2019, ZRrE, 28.3.2019.

29 LKA, 03/L-202, nenet 10.1 dhe 21.

30 KI 11/09, *Krasniqi k. RTK dhe KEK*, Vendim, GjK, 16.10.2009, f. 3, para. fundit.

31 Përgjigje në ankesën e palëve të interesuara, 15.6.2020, para. 23.

IV. PROPOZIM

42. Në përmbyllje, Gjykata duhet të largojë nga procedura parashtruesit e vetidentifikuar si «VBS» SH.P.K. dhe «Building Construction», të shpërfillë argumentet për konstatimin e fakteve lidhur me nenin 22 LKA, si dhe të refuzojë kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit për çështje të procedurës dhe të së drejtës materiale.
43. Mbështetur në argumentet e mësipërme dhe duke u thirrur në nenin 54.1 të Ligjit për konfliktet administrative, paditësi i kërkon Gjykatës së nderuar të nxjerrë këtë:

AKTGJYKIM

- I. **Refuzohet** si **e pathemeltë** kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit, e 30 qershorit 2020, e palëve të interesuara «Alsi & CO – Kosovë L.L.C» SH.P.K. me numër unik identifikues 810875552, «Vita Energy» SH.P.K. me numër biznesi 71218376, «Abrazen LLC» me numër biznesi 70100453, «Energy Development Group Kosova» SH.P.K. me numër biznesi 717276643 dhe «Solar Gate LLC» me numër biznesi 71280888.
- II. **Vërtetohet** Aktvendimit AA.nr.355/2020 të Gjykatës së Apelit të Kosovës, me të cilin është vërtetuar Aktvendimi i 6 prillit 2020 i Gjykatës Themelore të Prishtinës në lëndën A.nr.3090/19.

Përfaqësuesi i paditësit:

Dr. Getoar Mjeku, jur.

Rr. Enver Maloku, nr. 110

10000 Prishtinë

+383 45 30 52 00

gm@getoar.com